



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 809 Prot.

Tiranë, më 28.05. 2021

**Lënda:** Dërgohet rekomandim për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor përkatës për sigurimin e pajisjeve ndihmëse tiftoteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”.

**Znj. OGERTA MANASTIRLIU**

**MINISTËR**

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Adresa: Rruga e Kavajës, Nr. 1001, Tiranë

**TIRANË**

*Për dijëni:*

**Z. GRAMOZ RUÇI**

**KRYETAR**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4

**TIRANË**

**E nderuar znj. Ministre,**

Në kuadër të:

- ✓ ushtrimit prej Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me statusin e institucionit të pavarur publik, të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon:

*“Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”.*

- ✓ krijimit të terrenit të përshtatshëm ligjor për aplikimin dhe zbatueshmërinë efektive të detyrimeve konvencionale që burojnë nga Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, neni 4/1 i së cilës parashikon:

*“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuara pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”*

- ✓ zbatimit efektiv të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, miratuar në frymën e Konventës, për të garantuar nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron këtë Rekomandim me qëllim hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor përkatës për sigurimin e pajisjeve ndihmëse tifloteknike<sup>1</sup> për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar.

Rekomandimi synon eliminimin e situatës diskriminuese, në dëm të personave me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, e krijuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimit për nxjerrjen e akteve nënligjore, në bazë e për zbatim të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar si dhe Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statutin e invalidit”, i ndryshuar.

Sjellim në vëmendje se KMD ka adresuar rekomandim me të njëjtën përmbajtje, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresë Nr. 420 Prot, dt. 06.03.2020, me lëndë: “Dërgohet Rekomandim për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor përkatës për sigurimin e pajisjeve ndihmëse tifloteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”. Në përfundim, KMD ka kërkuar përcjelljen e informacionit, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, në lidhje me veprimet që do të ndërmarrën nga ana e Ministrisë së

---

<sup>1</sup> Megjithëse nuk ka një listë përcaktuar të pajisjeve ndihmëse, në zbatim të parashikimit në Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar, sikurse evidentohet në përmbajtje, për efekt të këtij rekomandimi, me pajisje ndihmëse tifloteknike do të kuptohet çdo libër në brail apo folës, mjet, aparat, paisje apo program që i shërben qytetarit të verbër për të patur akses në informacion, autonomi në lëvizje, vetëveprim dhe në edukimin e përgjithshëm dhe atë profesional. Pajisjet ndihmëse tifloteknike mund kategorizohen si vijon: 1. Paisje ndihmëse për jetesën e përditshme; 2. Paisje ndihmëse për arsimimin; 3. Paisje ndihmëse mbi teknologjinë e informimit dhe komunikimit; 4. Paisje ndihmëse për orientimin dhe lëvizshmërinë; 5. Paisje ndihmëse për personat me shikim të pjesshëm.

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucion përgjegjës, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Duke qenë se situata e pandemisë së Covid-19, e shpallur menjëherë më pas në vendin tonë, ka përballur Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucion për menaxhimin e situatës dhe ka diktuar një sfidë të madhe, KMD mirëkupton mos-dhënien e vëmendjes së duhur në adresim të kësaj problematike që parashtrohet në rekomandim.

Për këtë arsye, vlerësuam nevojën për ri-adresimin e këtij rekomandimi, i cili në vetvete përmban, nga njëra anë, një çështje sensitive për personat me aftësi të kufizuara në shikim dhe nga ana tjetër, një detyrim për t'u përmbushur nga shteti, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe standarteve për personat me aftësi të kufizuara.

## **I. SITUATA DISKRIMINUESE DHE ANALIZA E LEGJISLACIONIT TË ZBATUESHËM**

Në kuadër të trajtimit të kësaj problematike, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi analizoi legjislacionin e mëposhtëm:

### **Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”**

#### *Neni 2 - Qëllimi*

*“Ky ligj ka si qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes si dhe përcakton përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”*

#### *Neni 3 - Përkufizime*

1. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.
3. “Pengesat” nënkupton:
  - a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;
  - b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar;
  - c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;
  - ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika

9. "Persona me aftësi të kufizuara" janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

10. "Përfshirje" është pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona.

#### Neni 4 - Parimet

a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;

b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;

ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve;

d) përfshirja, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;

#### Neni 5 - Jetesa e pavarur

1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

#### Neni 9 - Mjetet ndihmëse

1. Mjetet ndihmëse u sigurohen personave me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për pajisje të tilla, për të kapërcyer pengesat, bazuar kjo në vlerësimin e bërë nga komisioni, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji.

2. Sigurimi i mjeteve ndihmëse rregullohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe koordinohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

### Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

#### Neni 4 - Sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor

1. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor bazohet në kontributet e të punësuarve e të punëdhënësve të shtetit dhe në burime të tjera për persona të tjerë, siç parashikohet në këtë ligj, bazuar në parimin e solidaritetit.

#### Neni 5 - Personat e siguruar

"2. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, kategoritë e mëposhtme të personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj:

b) personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës;

Neni 10 - Paketa e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm

“1. Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen: a) vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike;...

2. Paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm hartohen duke përcaktuar: c) listën e pajisjeve mjekësore, si dhe masën e mbulimit të tyre.”.

**Ligji nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**

Neni 2 E drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë themelore e individit; garantimi i të drejtave të barabarta në kujdesin shëndetësor, bazuar në mosdiskriminim”

Neni 3, “7. Sistemi i kujdesit shëndetësor” është organizimi, financimi dhe shpërndarja e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, ku përfshihen: promovimi dhe parandalimi shëndetësor; shërbimi diagnostikues, terapeutik dhe rehabilitues; politikat e kujdesit shëndetësor, ligjet, rregulloret dhe standardet për zbatimin e politikave dhe bashkëveprimet të qeverisë qendrore, vendore dhe ofruesve publikë ose privatë të shërbimeve shëndetësore.”

**Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar**

Neni 1 Përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësore janë të paaftë për punë në kushte normale.

Neni 3 Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes....

Neni 9 Shteti bën sigurimin shëndetësor të të verbërve falas, si dhe përfitimin e ilaçeve dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore falas, deri në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcakton listën e pajisjeve ndihmëse.

Neni 15 Personat e verbër të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji përfitojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statutin e invalidit".

**Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", i ndryshuar**

Neni 8 pika 1

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pajisjen e invalidëve me:**

a) mjete lëvizëse dhe pajisje të ndryshme ortopedike;

b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;

c) me mjete ndihmëse kardiake etj.

**Sjellim në vëmendjen Tuaj** parashikimin ligjor me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 381, datë 20.5.1996, ndryshuar me VKM nr. 385, date 14.7.2000, VKM nr. 437 datë 26.6.2003, “Për zbatimin e ligjit nr.7889, date 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i cili në pikën 4 të tij sanksiononte:

*“Në zbatim të nenit 8 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i akordohet çdo vit nga buxheti i shtetit një fond në lekë për blerjen: a) e mjeteve lëvizëse dhe të pajisjeve të ndryshme ortopedike; b) e mjeteve ndihmëse dëgjimore e pamore speciale; c) e mjeteve ndihmëse kardiake etj. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 1.5.1995.”*

Pra kjo VKM, në pikën 4 të saj, rregullonte marrëdhënien e sanksionuar në nenin 8 pika 1 të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", i ndryshuar, duke parashikuar akordimin e një fondi të veçantë çdo vit për blerjen e mjeteve ndihmëse dëgjimore pamore, të cilat do të administroheshin nga Instituti Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet një Rregulloreje të posaçme të këtij instituti.

**Rezulton se ky rregullim ligjor ka qëndruar në fuqi deri në vitin 2008, kohë kur u shfuqizua me VKM Nr. 869, datë 18.06.2008 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Statusi i Invalidit".**

Ky Vendim i Këshillit të Ministrave nuk ka parashikuar, në asnjë pikë të tij, rregullimin në lidhje me nenin 8 pika 1 të Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", duke mos mundësuar vijimin e procedurave nga ana Institutit të Sigurimeve Shoqërore për blerjen dhe pajisjen e personave të verbër *me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale; ne thelb duke lënë të pazbatuar detyrimin ligjor, të përcaktuar sipas nenit 8 pika 1 të Ligj 7889/1994 "Për statusin e invalidit".*

Aktet juridike duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Në këtë kuptim, Vendimi Këshillit të Ministrave Nr. 869, datë 18.6.2008 nuk ka reflektuar detyrimin kushtetues të të qënurit në përputhje me dispozitën ligjore, nenin 8 të Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".

Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statutin e invalidit", i ndryshuar, si dhe Ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, në nenet përkatëse 20 dhe 17 kanë parashikuar të drejtën dhe detyrimin Tuaj për *nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve.*

Në të njëjtën linjë, kemi evidentuar se në “**Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020**” është konstatuar se lëvizja e pavarur në rrugë dhe në trotuare është pothuajse e pamundur për personat në karrige me rrota apo që përdorin shkop mungojnë mjetet ndihmëse si shkopinjte e bardhë ,qentë orientues dhe qentë ndihmës.



Ndaj, ky Plan Veprimi kishte të parashikuar Qëllimin Strategjik nr. 6, sipas të cilit, duhet: ***“Të sigurohet një kujdes shëndetësor i aksesueshëm, i përballueshëm dhe i barabartë për personat me aftësi të kufizuara.”***

Objektiv 3 i këtij Qëllimi Strategjik, parashikonte detyrimin që:

**“Të planifikohen buxhetet për sigurimin e mjeteve ndihmëse (karrige me rrota, aparate dëgjimi, etj)”**.

Aktualisht, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, nuk është më në fuqi dhe Ministria ka hartuar një *“Plan Kombëtar Veprimi për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 -2025”*, i cili është në fazë drafti final.<sup>2</sup> Duke qenë se ky Plan i hartuar rishtazi është konsultuar nga KMD, sjellim në vëmendje se kemi konstatuar që masa e parashikuar në Planin e mëparshëm të Veprimit, për planifikimin e buxhetit për sigurimin e mjeteve ndihmëse (karrige me rrota, aparate dëgjimi, etj), **është hequr**.

**Në kushtet kur, ky qëllim strategjik nuk është realizuar dhe nevoja ekziston ende për të planifikuar buxhet për sigurimin e mjeteve ndihmëse, Komisioneri vlerëson që të tërheqë vëmendjen e institucionit përgjegjës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për parashikimin e këtij qëllimi strategjik në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 -2025.**

## **II. STANDARTET E ZBATUESHME PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, në nenin 55, përcakton se: *“1. Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.”* Pra, Kushtetuta e lidh ngushtësisht këtë të drejtë me barazinë e shtetasve si dhe me ndalimin e diskriminimit ndërsa e vendos këtë të drejtë si një parim bazë në politikën e shtetit.

**2. Konventa e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”**, ratifikuar me Ligjin nr. 108/2012, dt. 15.11.2012, ka për qëllim të promovojë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat, përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

*Personat me aftësi të kufizuara*, bazuar në këtë Konventë, përfshijnë ata persona që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barrierat e ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

*Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar*, sipas kësaj Konvente, ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të

---

<sup>2</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/333>

gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes së arsyeshme.

Lidhur me *garantimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuar*, kjo Konventë parashikon se, me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerët, të kenë akses në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale...

Gjithashtu, Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për: (f) Të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar për tu siguruar që ata të kenë akses në informacion. (h) Të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të aksesueshme me një kosto minimale.

**3. Ligji nr. 10 221, dt. 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”** përcakton se aftësia e kufizuar përbën një shkak të mbrojtur diskriminimi.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Neni 7, pika 1, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

**Mohimi i përshtatjes së arsyeshme** parashikohet si formë diskriminimi në nenin 3, pika 7, të ligjit, ku thuhet shprehimisht se: *“Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji”.*



Sa më lart, rezulton se *“rregullimi i domosdoshëm dhe i përshtatshëm”* që nevojitet në rastin në fjalë është sigurimi i pajisjeve ndihmëse tifloteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për statusin e te verbërit”*, i ndryshuar.

### III. KONKLUZIONE

1. Të drejtat e njohura me ligj për personat e verbër, të parashikuara në Nenet 8 dhe 9, të Ligjit nr. 8098, dt. 28.03.1996, *“Për statusin e të verbërit”*, i ndryshuar, në Nenin 8, pika 8.1, i Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 *“Për statutin e invalidit”*, i ndryshuar, në Nenin 10, Pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, *“Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”* që garantojnë të drejtën për përfitimin e ilaçeve dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore falas, deri në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave (Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcakton listën e pajisjeve ndihmëse), për mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale si dhe për kryerjen e vizitave, ekzaminimeve dhe trajtimit mjekësor në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike, nuk janë respektuar.

#### 2. Mungon akti nënligjor përkatës për sigurimin e pajisjeve ndihmëse tifloteknike

Bazuar në Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”*, i ndryshuar, shteti duhet të sigurojë përfitimin e pajisjeve ndihmëse mjekësore falas, deri në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit përcakton listën e pajisjeve ndihmëse. Në vijim, përcaktohet se personat që përfitojnë në kuadër të këtij ligji, *përfitojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statutin e invalidit”*. Ky i fundit parashikon se Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pajisjen e invalidëve me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale, ndër të tjera.

3. Në vlerësimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, qasja e shtetit shqiptar, si vend ratifikues pa rezerva i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe me standarte ligjore të larta kombëtare, nuk duhet të jetë ajo e regresit pra e shfuqizimit të një akti ligjor që ofron garanci për personat me aftësi të kufizuara, në rastin në fjalë për personat me aftësisë të kufizuara në shikim, por drejt rritjes së këtyre standarteve dhe garancive.

4. Materializimi i shumë të drejtave për qytetarët, bëhet nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore. Duke mos vepruar, duke mos miratuar aktet nënligjore të urdhëruara nga ligji për t’u miratuar, institucionet përgjegjëse u mohojnë qytetarëve të drejtën për të përfituar nga një e drejtë që i’u njihet me ligj.

5. Bazuar në analizën e legjislacionit kombëtar në fuqi dhe atij ndërkombëtar të ratifikuar nga vendi ynë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vëren se mungesa e pajisjeve ndihmëse ndihmëse tifloteknike, për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Per*

*statusin e te verbërit*”, i ndryshuar, ka karakter diskriminues dhe vjen në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit.

Mungesa e këtyre mjeteve ndihmëse speciale përbën një *kufizim*, bazuar në aftësinë e kufizuar të këtij grupi personash apo komunitetit të të verbërve në Shqipëri, të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm shqiptar, të parashtruara sa më lart.

**6. Si përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se sigurimi i pajisjeve ndihmëse tifloteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e te verbërit”, i ndryshuar, duhet të rregullohet me një akt nënligjor që do përmbushte këtë qëllim.**

Sa më lart, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

#### **REKOMANDON:**

- **Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor përkatës për sigurimin e pajisjeve ndihmëse tifloteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e te verbërit”.**

Lutemi përcjelljen e informacionit, brenda 30 ditëve nga marrja dijëni, në lidhje me veprimet që do të ndërmerren nga ana Juaj, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

**KOMISIONERI**

**ROBERT GAJDA**